Mikrobioma orale si përcaktues i shëndetit oral dhe sistemik: rishikim narrativ i lidhjes me sëmundjet kronike

Neila Bajrami[1*], Ergys Ramosacaj[2]

[1] *Departamenti i Diagnostikës dhe Rehabilitimit Shëndetësor, Infermieristikës në Kirurgji dhe Infermieristikës në Obstetrikë-Gjinekologji, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri*

[2] *Departamenti i Lëndëve Paraklinike, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri*

* Autori prezantues: Neila Bajrami, nejla.bajrami@umed.edu.al

Hyrje: Kaviteti oral strehon një ekosistem mikrobik kompleks, mikrobiomën orale, me mbi 700 lloje bakteresh, si dhe kërpudha, arkea e viruse. Në epokën e plakjes së popullsisë dhe të sëmundjeve kronike, roli i mikrobiomës orale në shëndetin oral dhe sistemik po merr rëndësi të veçantë. Ky punim synon të përmbledhë evidencat aktuale mbi funksionet e mikrobiomës orale, mekanizmat e disbiozës, lidhjen me sëmundjet orale dhe sistemike te të moshuarit, dhe perspektivat terapeutike.

Metodat: U krye rishikim narrativ i literaturës në PubMed dhe në motorin e kërkimit Consensus, për periudhën 2012–2026, me fjalët kyçe "oral microbiome", "dysbiosis", "periodontitis", "systemic disease" dhe "aging". U përfshinë rishikime narrative dhe sistematike, meta-analiza dhe raporte konsensusi. Nuk u ndoq protokoll sistematik dhe nuk u vlerësua cilësia.

Rezultatet: Në eubiozë, mikrobioma orale, e dominuar nga gjini komensale si *Streptococcus*, *Actinomyces* dhe *Neisseria*, pengon kolonizimin nga patogjenët, rregullon përgjigjen imune të mukozës dhe, përmes baktereve reduktuese të nitrateve, ndihmon rregullimin e presionit të gjakut. Higjiena e dobët orale, sheqeri, duhanpirja, hiposalivacioni, antibiotikët dhe sëmundjet sistemike nxisin disbiozën. Me plakjen ulet diversiteti mikrobik dhe rritet prania e patogjenëve periodontalë. Disa baktere të florës normale të gojës sillen si patogjenë (patobiontë) kur prishet ekuilibri ose kur kalojnë në inde të tjera. Disbioza qëndron në bazë të kariesit dentar, periodontitit, kandidozës orale dhe halitozës. *P. gingivalis* vepron si patogjen kyç: edhe në numër të vogël e rimodelon mikrobiotën normalisht beninje në disbiotike dhe nxit inflamacion. Në nivel sistemik, ajo lidhet me sëmundjet kardiovaskulare, diabetin (në marrëdhënie dykahëshe me periodontitin), pneumoninë nga aspirimi te të moshuarit, sëmundjen e Alzheimerit, artritin reumatoid, preeklampsinë dhe kancerin kolorektal të lidhur me *F. nucleatum*. Probiotikët, prebiotikët dhe bakteriofagët mund ta rivendosin eubiozën, por evidenca klinike mbetet e pamjaftueshme.

Përfundime: Ekuilibri i mikrobiomës orale është përcaktues i rëndësishëm i shëndetit të përgjithshëm, veçanërisht te të moshuarit dhe te pacientët me sëmundje kronike dhe multimorbiditet. Kujdesi parandalues oral dhe këto ndërhyrje ofrojnë mundësi premtuese për uljen e barrës së sëmundjeve. Përdorimi klinik kërkon standardizimin e raportimit, sipas udhëzimeve si STORMS (Strengthening The Organization and Reporting of Microbiome Studies). Nevojitet integrimi i kujdesit dentar me atë mjekësor.

Fjalët kryesore: mikrobioma orale; disbioza; periodontiti; sëmundjet kronike; plakja e popullsisë

Seksioni shkencor: T2 – Sëmundje Kronike dhe Multimorbiditet

Preferenca e prezantimit: Prezantim poster